



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**

Nr. 457/2023  
Datë: 14.01.2023

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 dhe 96 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 (1.4) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9) dhe nenin 11 (1) të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Z. Lazar Radulović emërohet Zëvendësministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.
3. Zëvendësministri, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është e obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Vendimi i dërgohet:**

- Z. Lazar Radulović, Zëvendësministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.